



Prishtinë: 18.07.2012

Kodi i ZRRE-së: V_427_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_800_05_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreu IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_800_05_2012**; dhe
5. Ankesën e konsumatorit me datë 11.06.2012;

Në mbledhjen e mbajtur më 18 korrik 2012, nxorri këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Kadri Berisha (shifra në KEK: DPR – 90002279) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_800_05_2012 i datës 01.06.2012.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 26.03.2009 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar që objekti është i shkyçur për shkak të borxhit, por që furnizohet pa matje. Ekipi i KEK-ut po ashtu ka bërë fotografime si dhe ka bërë regjistrimin e pajisjeve që posedon konsumatori në momentin e inspektimit.

Me datë 30.03.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse prapë kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar që kabli i minimarketit në të cilin është lidhur podrumi, është i zhveshur, nuk dihet koha e kyçjes direkt të podrumit por që me rastin e shkyçjes së lokalit në katin e parë është lidhur edhe kjo pjesë direkt në podrum.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 30.03.2009 e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP07510 në vlerë prej 2,515.07€. Pa kësaj ngarkese të bërë nga KEK-u konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. Departamenti për Konsumator në KEK pas ankesës së bërë nga konsumatori ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 01.06.2012 ka nxjerr vendim duke **refuzuar pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR09HP07510 e datës 30.03.2009 në vlerë 2,515.07€, dhe të me faturë të rikthimit të humbjeve për periudhën dy



mujore 02/2009 deri më 03/2009 duke respektuar nenin 12 të Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, më datë 11.06.2012 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar në tërësi vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_800_05_12 të datës 01.06.2012.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18.07.2012 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht kundërshtimet e theksuara në ankesë ndaj vendimit të DMK-së.

Bordi i ZRRE-s pas shqyrtimit të procesverbaleve të KEK-ut ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 07.02.2009 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë bërë shkyçjen e njehsorit elektrik nr. 2352910 nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit dhe pas shkyçjes është vulosur me vulë distributive A 10036036. Pas këtij inspektimi punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 26.03.2009 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë evidentuar që objekti është i shkyçur për shkak të borxhit, por që furnizohet pa matje.

Sipas analizave të bëra procesverbaleve të KEK-ut nr. 324529 të datës 26.03.2009 dhe procesit nr. 324533 të datës 30.03.2009 është vërejtur se gjendja e kWh të evidentuara në dy proceset e KEK-ut janë të njëjta me gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në procesin nr. 241442 të datës 07.02.2009, që tregon se konsumatori për periudhën nga shkyçja deri në inspektimin e fundit të datës 30.03.2009 nuk ka të regjistruar energji të shpenzuar.

Sipas analizës së bërë listave të leximit të KEK-ut është vërejtur se lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se në listat e leximit nga periudha 10/2008 deri më 01/2009 ka konstatuar se njehsori elektrik nr. 2352910 është në rregull, ndërsa në listat e leximit në periudhat 02/2009, 03/2009 dhe 04/2009 lexuesi i KEK-ut ka konstatuar se mungon vula distributive.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar faturën e rikthimit të humbjeve DPR09HP07510 të datës 30.03.2009 të përpiluar nga Departamenti i faturimit në KEK dhe konstaton se KEK sha ka gabuar pasi që nuk është respektuar nenin 12 i Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të energjisë elektrike. Sipas procedurës llogaritja e faturës së rikthimit të humbjeve për konsumatorët jo shtëpiak duhet të bëhet bazuar në pajisjet që posedon konsumatori me rastin e inspektimit e jo sipas seksionit të kabllit si ka vepruar Departamenti i faturimit në KEK.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18.07.2012 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. **ZRRE/DMK_V_800_05_2012**, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar